**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRES**

Nr 821 Prot. Durrës.më 13 /03 /.2023

## SHPALLJE

## E VENDIT TË LIRE PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPA)

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës . në zbatim të Ligjit 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. VKM nr.99. datë 27.02.2019 "Për krijimin. mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauni versitar", Udhëzimit nr.2. datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit. uljes në detyrë. pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar" i ndryshuar. shpall vendin e lirë të drejtorit të institucionet arsimore publik të arsimit paraunversitar IPAP bashkelidhur shpalljes:

1. **Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPA:**

a) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar", me vlerësimin jo më pak se " Mirë" , në kualifikimin e fundit.

b) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;

c) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshme përgatitor për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor *ose* të jetë pranuar për të kryer atë.

d) **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

1. **Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban:**

a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1. bashkëlidhur këtij udhëzimi);

kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;

c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën

4. bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) certifikatën e drejtuesit të IPA ose vërtetimin nga shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2. bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinorc në fuqi:

h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPA (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër. femijë në moshë madhore. prindër të bashkëshortit/bashkëshortes). sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3. bashkëlidhur këtij udhëzimi.

**Drejtori aktual i IPA ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme:**

e) planin afatmesëm të shkollës;
f) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
g) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 ,të shkronjës B. dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-in përkatës jo më vonë se **10 dite nga data e shpalljes së vendit te lire.**

2. **Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.**

Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data __.___**.2023.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohcn nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

3. **Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë do të kryejnë intervistën e strukturuar për:**

Fusha e njohurive dhc aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

a) Ligji 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

b) Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026.

c) Urdhër nr.31, datë 19.01.2020 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

d) Udhëzim nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë".

e) Udhëzimi nr.30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar".

f) Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit,uljes në detyrë,pezullimit dhe të

shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar". i ndryshuar.

g) Udhëzimi nr.3, datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar".

h) Ligji nr.9367. datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

i) Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

j) Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

4. Rezultatet përfundimtare të konkurimit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor përkatës sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.2. datë 28.01.2020 "Për procedural e emërimit,uljes në detyrë. pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar". i ndryshuar Kreu 1, shkronja C. pika 10/g.

5. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit.

6. Procedurat e mëtejshme vazhdojnë sipas Kreut 1. shkronja D të Udhëzimit.

**Bashkëlidhur lista me vendet vakante për ZVAP bashkëlidhur.**

**GRAFIKU I KONKURSEVE PËR DREJTOR TË IPAP**

| NR. | DRAP | ZVAP | INSTITUCIONI ARSIMOR |
|---|---|---|---|
| 1 | DURRES | Durrës | "Shaqe Mazreku" |
| | | | |

**Hazbi LIKA**